



ITALIAN TRADE AGENCY

Zyra Tiranë

## Njoftim Shitje asete të luajtshme

Zyra e Agjencisë ICE në Tiranë synon të shesë mobilje dhe pajisje, sipas listës bashkëlidhur, që nuk janë më të përdorshme, pasi janë të prishura ose të dëmtuara.

Çmimi bazë është 260.00 euro (dyqind e gjashtedhjetë euro). Mallrat do t'i shiten ofruesit që jep çmimin më të lartë, ku përfshihet edhe tërheqja e mallit/transporti.

Është e mundur të shikoni mallrat e sipërpërmendura pranë Zyrës ICE në Tiranë duke caktuar një takim në adresën [tirana@ice.it](mailto:tirana@ice.it).

Fatura do të lëshohet nga selia jonë qendrore në Romë dhe duhet të paguhet në llogarinë tonë rrjedhëse pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania. Komisionet bankare dhe taksa e pullës do të jenë në ngarkim të blerësit.

Blerësit e mundshëm duhet të paraqesin ofertat e tyre në një zarf të mbyllur (sipër të cilit të shkruhet "shitje mobiljesh dhe pajisjesh jo të përdorshme") personalisht pranë Zyrës ICE në Tiranë ose t'i dërgojnë ato me postë në adresën tonë: Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, Kati II, Tiranë - Shqipëri.,

Ofertat duhet të paraqiten brenda **orës 12.00, datë 5 korrik 2021**. Për këtë do të jetë e vlefshme data e protokollit e vendosur mbi zarf.

Zarfet do të hapen në publik (përmes lidhjes digjitale) nga Zyra ICE në Tiranë me datë 7 korrik 2021, në orën 11:00 nga komisioni përkatës. Për të marrë pjesë në hapjen e zarfeve, duhet të dërgoni një e-mail në adresën [tirana@ice.it](mailto:tirana@ice.it) deri në orën 12.00 të datës 5 korrik 2021.

Rezultatet e garës do të publikohen në faqen e internetit të Zyrës ICE në Tiranë (<https://www.ice.it/en/markets/albania>) me datë 7 korrik 2021.

Përshëndetjet më të mira

Elisa Scelsa  
Drejtori